



**VENDIM**

***Nr.42 Datë 25.05.2009***

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE STANDARTE  
TË PROKURIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OSSH sh.a.**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” te ndryshuar, Ligji Nr. 10116, datë 23.04.2009, “Për Miratimin e Kontratës së Shitjes së 76 % të Aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjistikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s- së”, (Aneksi 11), Ligjit Nr. 10126 datë 11.05.2009, “Për Miratimin e Marrveshjes së Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për Garantimin e Projektit të Privatizimit të OSSH sh.a”, Bordi i Komisionerëve ne mbledhjen e tij të datës 25.05.2009, duke konstatuar se Procedurat standarte të Prokurimit të Energjisë Elektrike nga OSSH sh.a., janë pjesë përbërëse e ligjit nr. 10126, datë 11.05.2009,

**VENDOSI:**

- 1-** Miratimin e Rregullave dhe Procedurave Standarte të Prokurimit të Energjisë Elektrike nga OSSH sh.a., sipas procedurave që përmban Aneksi 1 i marrveshjes së Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për Garantimin e Projektit të Privatizimit të OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari I ERE-s**

**Bujar Nepravishta**

**Ne mungese dhe me porosi**

**Ardian Haci**